

**DRAFTI I**  
**RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT**  
**NE MJEDIS**  
**TE AKTIVITETIT**

**“Linje per perpunimin dhe imbotilimin e ujit te pijshem”**



**Subjekti:** “Jeta 1” sh.p.k

**Vendndodhja:** Ne territorin e lugines se perroit te Bogoves, ne vend-bashkimin e perrenjve Dobrusha dhe Sade, komuna Bogove, rrethi Skrapar, qarku Berat.

**Pergatiti materialin:** Eko-Studio-Projekt sh.p.k

**ADMINISTRATORI:** Shkëlzen MADANI

**Tirane, 2016**



# **PERMBAJTJA**

-  Hyrje
-  Baza ligjore

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
  
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
  
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
  
4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
  
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**



## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

### **“Linje per perpunimin dhe imbotilimin e ujit te pijshem”**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- Ligji nr. 10 431, date. 09.06.2011 *“Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- Ligji nr. 10266 date 15.04.2010 *“Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- Ligji nr 162/2014 *“Per mbrojtjen e cilesise se ajrit”*
- Ligji nr. 9010, date.13.02.2003 *“Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- Ligji nr. 116/2014 *“Per akreditimin e laboratoreve testues kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues ne Republiken e Shqiperise”*
- VKM Nr.435, date.12.09.2002 *“Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”*
- VKM Nr.103, date. 31.03.2003 *“Per monitorimin e mjedisit ne Republiken e Shqiperise”*
- VKM Nr.177, date. 31.03.2005 *“Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengta dhe kriteret e zonimit te mjedisive ujore pritesa”*
- Ligji Nr.9115, date. 24.07.2003 *“Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotur “*
- VKM Nr. 248, date 24.04.2003 *“Per miratimin e normave te perkohshme te shkarkimeve ne ajer dhe zbatimin e tyre”*
- Ligji nr.8094 date 21.03.1996 *“Per largimin publik te mbeturinave”*
- VKM 1189, date 18.11.2009 *“Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e Programit Kombetar te Monitorimit te Mjedisit”*
- Udhëzim, Nr.8, dt.27.11.2007 *“Për nivelet kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*



## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

### **➤ Profili i propozuesit**

Subjekti "Jeta 1" sh.p.k me numer NIPT-I K79010410B do te ushtroje aktivitetin e perpunimit dhe imbotilimit te ujit te pijshem.Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te tipit B.

### **Pershkrimi i qellimit te propozuar**

Subjekti "Jeta 1" sh.p.k Berat eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne vitin 2007. Ky subjekt ushtron veprimtarine e tij ne fushen e perpunimit dhe imbotilimin e ujit te pijshem.Fabrika per perpunimin dhe imbotilimin e ujit te pijshem ndodhet ne territorin e lugines se perroit te Bogoves, ne vend-bashkimin e perrenjve Dobrusha dhe Sade, komuna Bogove, rrethi Skrapar, qarku Berat.Per zhvillimin normal te ketij aktiviteti punojne rreth 11 punetore. Kapaciteti i prodhimit te ujit ne kete fabrike eshte 150 litra/minute.

## **KOORDINATAT E VENDNDODHJES**

<b>Numri</b>	<b>Koordinata X</b>	<b>Koordinata Y</b>
<b>1.</b>	<b>4427675</b>	<b>4493395</b>
<b>2.</b>	<b>4427754</b>	<b>4493514</b>
<b>3.</b>	<b>4427775</b>	<b>4493448</b>
<b>4.</b>	<b>4427833</b>	<b>4493411</b>

### ***Pershkrimi i procesit te punes***

Perpunimi i lendes se pare sic eshte uji natyral si dhe prodhimi i produktit te gatshem te ambalazhuar realizohet nga ana e shoqerise me nje teknologji moderne, e cila rrit qendrueshmerine e produktit tregtar, si dhe duke e bere te tregtueshem per konsumatorin.

### **Filtrimi**

Filtrimi eshte operacion teknologjik ne te cilin behet ndarja e fazave te ngurta nga suspensioni. Uji vleresohet me shkalle te larte te pastertise, tejdukshemrise. Per te fituar uje me tejdukshmeri te larte duhet bere kthjellimi artificial i tij. Proceset kryesore te kthjellimit jane: filtrimi, pasterizimi dhe rrezatimi me ultraviolet. Per kete arsye, procesi i filtrimit behet me presion me te larte se sa presioni qe ka vepruar ne fazen e ardhjes. Filtrat mekanik kane nje karakteristike te perbashket, sepse jane elemente poroze te renditura njera pas tjetres ne pozite vertikale ose horizontale, ku ne mes tyre formohen hapesirat e zbrazeta per tu formuar pogaqja filtruese. Pajisjet e propozuara per kete teknologji jane:

- Gjenerator ozoni ( prodhues i Ozonit ne vend)
- Komprimues Oksigjeni per prodhimin e Ozonit;



- Injektor i Ozonit
- Pompe Uji
- Tank 500 litersh per reaktorin e Ozonit;
- Fuqia e Instaluar eshte 1 kW
- Filtri Mekanik perbehet nga keta elemente dhe ka keto karakteristika:
- Siguron shplarje me cikel automatik
- Kapaciteti i tij eshte 2500-6000 liter ne ore
- Dimensionet e kullës: 616 x 2105 mm
- Materiali mbushes: shtrese kokrizote guresh kuarcore me permasa ne shkallezim (5 shtresa)
- Shtrese kokrizore e imet ne mbyllje te ciklit.



### ***Dezinfektim i ujit me ozon:***

Pjese te ketij sistemi te dezinfektimit te ujit me ozon jane: Filtrimi mekanik; Filtrimi me karbon aktiv i cili sherben per filtrimin e materialeve organike dhe materialeve me arome te keqe e te papelqyeshme; Filtrimi i imet: me filtra cilindrike vertikale, 3 cope filtra, 50 cm te gjate dhe 0,2 mikron te imet. Filtri i imet: Sistem qirinjsh vertikale per optimum te filtrimit te imet, Intesia e poreve te shtreses filtruese 5mikron, 10mikron, 15mikron, 20mikron.

Me pas nga depozita uji kalon ne proceset e filtrimit si me poshte:

Filtri i karbonit;

Filtri i precizionit;

Holli filter (qe vret te gjitha mikrobet).



## **2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

### **Pozita gjeografike**

Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187 m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit Osum, para se ky të dalë në fushën e Myzeqesë, më e madhja e Shqipërisë. Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06"); gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

### **Cilesia e ajrit,temperature,reshjet atmosferike.....**

Klima e rrethit është tipike mesdhetare, me temperaturë mesatare vjetore 15,9 gradë C. Temperatura mesatare e muajve më të ftohtë është 7,2 gradë C dhe ajo e muajve më të nxehtë 28,2 gradë C. Temperatura absolute më e ulët ka qenë -12,2 gradë C dhe ajo maksimale 47,1 gradë C.

### **Relievi**

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territor me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455 m (qyteti 58 m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushën e Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës, mali i Tomorit (Lindje, 2417 m) dhe ai i Shpiragut (Perëndim, 1218 m) si edhe luginat e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike, ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

### **Flora dhe fauna**

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetem pak shkurre te vogla barishte. Te gjitha llojet e bimeve, qe rriten perreth objektit jane te karakterit lokal pa ndonje veçori dalluese dhe qe nuk gezojne ndonje status te veçante mbrojtjeje. Brenda zones se shfrytezimit jane te zhvilluar ne menyre te kufizuar shkuret dhe bimet lokale.



### **3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për të zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

#### ***Shkarkimet dhe mbetjet që prodhohen***

Shkarkimet në ambient i klasifikojmë sipas natyrës së tyre:

#### ***Shkarkimet në ajër***

Shkarkimi i gazrave të makinave shpërndarese të ujit janë burimet e mundshme të ndotjes së ajrit, të cilat mund të rrisin përqendrimit të materialeve të imta në të. Pjesa më e madhe e mjeteve do të operojnë në një ambient të hapur, me një dispersion të madh, për shkak të rrymave dhe erërave. Gjithsesi, ndikimi në ndotjen e ajrit, mund të konsiderohet i paperfillshëm, për shkak të levizjes të ulet të makinave të shpërndarjes së mallit.

#### ***Shkarkimet e lengeta***

Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë. Ujrat teknologjike të objektit dhe ujrat e përdorura për qëllime higjieno sanitare, shkarkohen në dekantorin e punishtës brenda territorit të objektit, dhe ujerat pasi dekantohen kalojnë në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zonës, pa shkaktuar probleme, ndërsa ujrat e zeza shkarkojnë në kanalizimet e ujrave të zonës.

#### ***Shkarkimet e ngurta:***

Gjatë periudhës së funksionimit, problemi i prodhimit të mbeturinave do të jetë i përndësishëm, sepse do të prodhohen mbeturina tepër të vogla nga vetë proceset e punës. Pritet gjithashtu, prodhimi i mbeturinave personale të punëtorëve dhe personelit. Mbetjet që dalin nga aktiviteti seleksionohen sipas llojit të materialit me pas depozitohen në vende të caktuara brenda territorit të sheshit të fabrikës dhe mbetjet urbane të akumuluar depozitohen në koshat më të afërta të plehrave të vendosur nga Pushteti Vendor.

#### ***Zhurmat (ose ndotje akustike)***

Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritët të kenë ndikim në popullatën përreth. Ky nivel zhurmash nuk ndikon në shëndetin e punonjësve të subjekti “Jeta 1” Sh.p.k. dhe as në shëndetin e personave që punojnë në ambientet përreth .





#### **4. MASAT PER ELEMNIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do te sigurohet marrja e masave si me poshte:

##### **Territorri perreth fabrikes**

I gjithë territori i fabrikes dhe sheshet e levizjes jane te shtruara dhe te sistemuara. Nga shoqeria jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth fabrikes duke bere te mundur mbjelljen me peme , gjithashtu nga stafi do tregohet kujdes per mbajtjen paster te ambientit dhe pastrimin e mjedisit ne ndonje rast ndotjeje.

##### **Emetimet ne ajer**

Referuar natyres se procesit sasia e gazeve te shkarkuar ne atmosfere eshte e vogel dhe brenda normave te lejuara dhe mund te konsiderohet fare e paperfillshme. Per cilesine e ajrit do te merren keto masa:Subjekti per te gjitha ambientet e punes do te kryeje pajisjen me filtra per kapjen e pluhurave qe mund te emetohen gjate proceseve te punes.Te merren masa per sigurimin e ajrosjes dhe ventilimit te ambienteve te brendshme ku do te zhvillohet aktiviteti.

##### **Mbetjet e ngurta**

Masat mbrojtese per mbetjet e ngurta jane:

Mbetjet e ngurta urbane qe nuk i ribashkohen procesit teknologjik, te largohen cdo dite nga vendgrumbullimi i tyre dhe te dergohen per ne vendgrumbullimet e percaktuara nga pushteti vendor.

Mbetjet dhe llumrat e dala nga procesi teknologjik te depozitohen perkohesisht ne mjedise te posacme,kazane metalike ose plastike,te cilat nuk bashkeveprojne me mbetjet dhe nuk lejojne derdhjet e tyre ne momentin e administrimit apo depozitimit ne vendin e percaktuar nga organet shteterore.

Te pastrohen menjehere rrjedhjet, derdhjet, pikimet, per te parandaluar ndotjen e tokes.

Mbetjet e ngurta urbane qe do te krijohen nga ambalazhimi i materialeve qe do te depozitohen ne magazine te riciklohen sa te jete e mundur dhe ato qe nuk mund te riciklohen te depozitohen ne pikat e caktuara nga Bashkia/Komuna.





### **Shkarkimet e ujerave**

Nuk do te kete ndikime ne ujera dhe as ndotje sepse proceset zhvillohen brenda territorit te fabrikes dhe asgje nuk del jashte saj.Per pasoje nuk do te kete ndotje te ujerave.

### **Zhurmat**

Duke gene se fabrika punon vetem me energji elektrike,nuk do te gjenerohen zhurma.Zhurmat qe do te emetohen vijne kryesisht nga ambientet e punes,ambalazhimi i shisheve te ujit mineral natyral dhe te gazuar.Keto zhurma do te mbahen ne kontroll dhe do te jene brenda normativave te lejuara per te mos patur ndikime negative ne mjedisin perreth.

### **Rastet aksidentale**

Do merren masat per parandalimin e tyre, pajisjet ne fabrike do kontrollohen vazhdimisht per gjendjen teknike te tyre. Shoqeria siguron se do kete nderhyrje te menjehershme nese do te kete ndikime negative ne mjedis.

### **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve ata do jene te mireinformuar mbi rregullat e sigurimit teknik gjate kryerjes se punes, konform rregulloreve perkatese per mbrojtjen e jetes dhe shendetit. Gjithashtu shoqeria do i pajise me uniforma dhe mjete mbrojtese.

### **Emergjencat në këtë objekt, mund të vijnë nga këto shkaqe:**

- **Rënia e zjarrit**

Në rastin e rënies së zjarreve, në territorin e Shoqërisë është e afishuar skema e lajmërimit. Mbi bazën e kësaj skeme personeli që ndodhet në Shoqëri vepron duke bërë njoftimin e PMNZSH në numrat e zjarrfikëseve të afishuara në tabelat përkatëse. Personeli present bazuar në skemën e afishuar vepron menjëherë me fikset e dorës dhe tenton të kufizojë përhapjen e mëtejshme të zjarrit. Pajisjet dhe instalimet do të mbrohen me sistemin e shumës antizjarr, si dhe shuarës zjarri portable dhe të lëvizshëm, të vendosur në vende të sigurta.

Brenda aktivitetit do të behen kontrole ditore kundra zjarrit,kontrolle mujore te hidranteve dhe gatishmeria e tyre nga ku mbahet edhe nje regjister per kontroll.Gjithashtu eshte vendosur sistemi akustik ne raste emergjence.

- **Evakuimi i detyruar i njerëzve në rast zjarri**

Pozicioni i objekteve/instalimeve përbërëse të subjektit, sipas destinacionit që ato kanë, është i tillë që jo vetëm respekton largësitë e mbrojtjes nga zjarri, por në rast zjarri është i zgjidhur edhe evakuimi i detyruar i njerëzve dhe mjeteve prej tyre.



- **Rënia nën tension**

Duke u nisur nga specifika që ka puna, është marrë në konsideratë edhe mbrojtja nga rënia nëntension e paisjeve dhe e personelit që punon aty. Dhe për këtë rast janë parshikuar veprimet e menjëhershme që do të kryhen.

- **Nga tërmetet**

Zona është e studiuar nga ana sizmike dhe bazamentet ku janë instaluar pajisjet dhe impianti, nuk përbëjnë rrezik për tërmetet. Kështu në rast tërmeti do të kishim vetëm lëkundje të tokës dhe nuk do të paraqesë rrezik për instalimin, objektet, personelin dhe për mjedisin përreth aktivitetit.

## **5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

### **KONKLUZIONE**

- ✓ Niveli i zhurmave të gjeneruara gjatë të zhvillimit të aktivitetit është në përputhje me vlerat kufi të përcaktuara në legjislacionin mjedisor në fuqi.
- ✓ Vlerësohet puna e bërë nga drejtuesit e subjektit "Jeta 1" Sh.p.k në drejtim të disiplinimit të veprimeve në mbajtjen e vlerave të nderhyrjes së agjentëve kimik, fizik e biologjik në mjediset e punës dhe në impaktin në mjedis të këtyre elementëve duke përdorur teknologji moderne dhe automatike të cilat bëjnë të mundur një punë me efikasitet dhe një impakt minimal në ambient.
- ✓ Mjediset e punës janë të pajisura me kuti të ndihmes së shpejte si dhe të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe çdo muaj instruktohen punëtorët për masat e sigurimit teknik.
- ✓ Subjekti ka marrë masa për përdorimin e tubacioneve me material të paoksidueshëm për transportin e ujit nga burimi ujor natyral, në linjen e prodhimit në stabiliment.

### **REKOMANDIME**

- ✓ Të mbahet vazhdimisht regjistri i mbetjeve të gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- ✓ Të kontrollohet kompletimi me mjete mbrojtëse nga zjarri, plan-sistemi i emergjencave i hartuar nga subjekti dhe zbatimi i rregullave dhe të mirembahen pajisjet.
- ✓ Të trajtohen në vazhdimësi punonjësit lidhur me kushtet e Lejes Mjedisore, me rregullat e sigurimit teknik dhe rregullat e mbrojtjes nga zjarri.

**PER "EKO-STUDIO-PROJEKT" sh.p.k**  
**Punoi: Msc.Ing.mjedisi Ana Naçi**

